

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË " Clinica Madre Teresa " SH.P.K.

Sot, me datë 07/01/2025

**-Z. Toldi Aleksi** , shtetas shqiptar, lindur më 23/08/1991 në Lushnje, mbajtës i kartes se ID me nr. Personal : J10823118T , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**Z.Kalion Aleksi**, shtetas shqiptar, lindur më 06/08/1994 në Lushnje, mbajtës i kartes se ID me nr. Personal : J40806121D , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Clinica Madre Teresa**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### NENI 1

#### EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është “ **"Clinica Madre Teresa "Sh.p.k.**

#### NENI 2

#### SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën : Tirane, Rruga e Kosovareve, ap nr.7, Shkalla B, Zona Kadastrale 8270.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### NENI 3

#### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

#### NENI 4

#### OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Sherbim marketingu.*

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 Lek (Njëqind mije) Lek dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Toldi Aleks**i zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lek dhe 50.000 Lek të kapitalit themeltar.
- **Z. Kalion Aleks**i zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lek dhe 50.000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Toldi Aleks**i, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.


## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### ORTAKËT THEMELUES

**Z. Toldi Aleks**i



**Z. Kalion Aleks**i

